



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:257473
Datë: 20.11.2023
Numri i dokumentit: 04945903

C.nr.256/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Egzon Mujaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Xh. S, R. S. dhe L. S., të gjithë nga G, Komuna e G, të cilët i përfaqëson me autorizim R. Z, avokat në P., kundër të paditurit M. B., nga G., përfaqësuar me autorizim nga Z. J., avokat në G., me objekt kontesti vërtetimin e pronësisë dhe anulim të kontratës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në prezencë të përfaqësuesit të paditësve dhe përfaqësuesit të të paditurit, me datë 20.11.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve X.S., R. S. dhe L. S., të gjithë nga Prishtina, me të cilën kanë kërkuar që të anulohet Aktvendimi, me numër 34 nr.360-70-15/92, i datës 20.11.1992, Aktvendimi me numër 34 nr.360-5353/98-2, i datës 28.12.1988, Kontrata për qiranë e banesës nr. 1193/15703, e datës 01.02.1993, Kontrata për shitblerjen e banesës nr. 452-167/99, e datës, 21.06.1999, të vërtetohet se paditësit si trashëgimtar të I. S., e kanë fituar të drejtën banesore, në banesën e cila gjendet në P., në lagjen “D.”, Rr.9, B-1, L-4, K-8, banesa numër .., në sipërfaqe prej 60.83 m2, sipas Aktvendimit mbi ndarjen në shfrytëzim të banesës me numër 04 nr. 360-82/73, i datës 21.04.1988, e cila ju kishte ndarë në shfrytëzim paraardhësit të tyre I. S., si dhe të detyrohet i padituri M. B., nga G., që ta liroj nga njerëzit dhe sendet këtë banesë dhe t’ua dorëzoj në posedim dhe shfrytëzim paditësve në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim, SI E PA BAZUAR.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paraardhësi juridik i paditësve në këtë gjykatë me datë 13.03.2006, ka paraqitur padi kundër të paditurit M. B., nga G, për anulim të kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmerisë, ku ka theksuar se paditësit ju ka ndarë në shfrytëzim banesa e cila gjendet në Prishtinë, në lagjen “D.”, Rr.9, B-1, L-4, K-8, banesa numër .., në sipërfaqe prej 60.83 m2, në bazë të Vendimit nga Sekretariati Krahinor për Punë të Brendshme, Bashkësia e II, punonjëse Këshillit të punëtoreve, numër 04 nr. 360-82/73, i datës 21.04.1988, e cila banese në bazë të vendimit të Kuvendit të Serbisë, në vitin 1989/90, i'a ndan të paditurit si pjesëtar i Policisë, pa kurrfarë baze juridike dhe në kundërshtim me rregullativën normative.

I autorizuari i paditësve, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe precizimit të kërkesëpadisë të datës 26.07.2023, duke kërkuar nga gjykata që ta aprovon në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve dhe të anulohet aktvendimi i MUP-it të Republikës së Serbisë, 04 nr.360-70-15/92, të datës 20.11.1992, me të cilën B. M., i është dhënë me qira në kohë të caktuar banesa dy dhomëshe nr.32, në katin e VIII, në sipërfaqe prej 60.83 m2, D. Rr.9, bl.1 lam.4 në P., të anulohet si i kundërligjshëm aktvendimi i Qeverisë të Republikës së Serbisë 34.nr.360-5353/98-2 të datës 28.12.1988, me të cilin B. M., i është dhënë me qira në kohë të pacaktuar banesa dy dhomëshe nr.32 në katin e VIII, në sipërfaqe prej 64 m2, D., rr.9 bl.1. lam 4 në P., të anulohet si e kundërligjshme Kontrata për Qiranë e banesës nr.1193/15703 të datës 01.02.1993, e lidhur në mes të Ndërmarrjes Publike Banesore në Prishtinë dhe B. M., nga P., të anulohet si e kundërligjshme kontrata për shitblerjen e banesës numër 45-167/99 e datës 21.06.1999, e lidhur në mes të Republikës se Serbisë, të cilën e përfaqëson zëvendës ministri për financa si shitëse dhe te paditurit M. B., si blerës e vërtetuar në Gjykatën e Parë Komunale në Beograd, VR.nr.361/2000, me datë 17.02.2000, të vërtetohet se paditësit Xh. S, R. S. dhe L., që të gjithë nga G., Komuna e G., si trashëgimtarë të paraardhësit juridik- babait, respektivisht gjyshit të tyre, ish paditësit I. S., se e kanë fituar të drejtën e pronësisë në banesën e cila gjendet në P., në lagjen “D.”, rr.9, Blloku 1, Lam.4, kati i 8, banesa nr., në sipërfaqe prej 60.83 m2, në bazë të aktvendimit mbi ndarjen në shfrytëzim të banesës 04 nr.360-82/73, të datës 21.04.1988, e cila ju kishte ndarë në shfrytëzim tani te ndjerit I. S., ish punëtor i Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme në Prishtinë, sipas dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet Banesore, si ligj në zbatim, sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut nr.24/1999, lidhur me Ligjin në zbatim në Kosovë. Të detyrohet i padituri B. M., apo çdo person tjetër eventual që gjendet në atë banesë, paditësve Xh. S., R. S. dhe L. S., që të gjithë nga G., Komuna e G.t, banesën, e cila gjendet në P., në lagjen “D.” rruga 9, Bloku 1, Lam.4, kati i 8, banesa nr., në sipërfaqe prej 60.83 m2, ta lirojnë nga njerëzit dhe sendet.

Po ashtu ka theksuar se të gjitha veprimet e organeve të dhunshme të Qeverisë së Republikës së Serbisë, lidhur me këtë çështje kontestuese janë marr në kundërshtim me dispozitat e nenit 32 të

Ligjit për Marrëdhëniet Banesore, të cilat veprime kanë qenë diskriminuese, në kundërshtim me Ligjin mbi Diskriminimin Nr.2004/3, i datës 19.02.2004. Gjithashtu me këto veprime janë shkelur edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Tutje ka theksuar se Vërtetimi i paluajtshmërisë lidhur me banesën kontestuese, i bërë në Beograd, në Gjykatën e Beogradit, është në kundërshtim me dispozitat e nenit 16 të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare Ksak nr.45/81,29/86 dhe 28/88, si dhe në kundërshtim me dispozitën e nenit 6 të Rregullores së UNMIK-ut, me Nr.1999/1, e cila ka hyr në fuqi me 10.06.1999, e sipas të cilës UNMIK, administron gjithë pasurinë e paluajtshme, duke përfshirë edhe financat, llogaritë bankare dhe format tjera të regjistruar në emër të RSFJ-së dhe RS, të Serbisë apo organet që gjenden në RKS, të gjitha këto veprime janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 (tani neni 4 i LMD-së), duke përfshirë dispozitën e nenit 203 (tani neni 99 i LMD-së), se të gjitha këto veprime, janë veprime nule dhe gjykata duhet ti anulojë të gjitha ato kontrata bazuar në dispozitat ligjore në zbatim, po ashtu ka shtuar se në pikën 6 në petitumin e parashtrësës së datës 26.07.2023, tek fjalia “kur e ka fituar të drejtën e pronësisë”, duhet të jetë “e kanë fituar të drejtën e banesore”, në bazë të aktvendimit të Sekretariatit Krahinorë të Punëve të Brendshme dhe hiqet “kontrata për bashkimin e mjeteve nr.02-6131/1, e datës 09.10.1985, andaj në këtë kuptim nga gjykata ka kërkuar që padinë dhe kërkesëpadinë e precizuar ta aprovon në tërësi të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për pesë seanca, nga 135 € në shumën prej 675 €, për pesë seanca nga 270.40 €, shumën prej 1,352 €, për padi shumë prej 135 €, për pesë parashtrësia nga 208 €, shumën prej 1,040, për ankesë shumën prej 208 €, e në shumë të përgjithshme prej 3,410 €.

I padituri me parashtrësën e datës 10.04.2013, ka theksuar se me Vendimin e Republikës së Serbisë, numër 360-5353/98-2, të datës 28.12.1988, e ka fituar të drejtën e shfrytëzimit të banesës e cila gjendet në P., D. UL-9, Blloku 1, Lam 4, nr. ., me sipërfaqe prej 64 m², Vendimin e MPB-së së Republikës së Serbisë 04 nr.360-70/92, të datës 20.11.1992 dhe Kontratën mbi dhënien në shfrytëzim të banesës numër 1193/15703, të datës 01.02.1993, të lidhur ndërmjet JSP-së, në Prishtinë dhe të paditurit, po ashtu ka shtuar se në bazë të akteve normative ka hyrë në posedim të banesës dhe të njëjtën e ka shfrytëzuar pa u penguar nga askush, qoftë në mënyrë juridike, qoftë në mënyrë faktike deri në përfundim të luftës në Kosovë, pas përfundimit të luftës në Kosovë, paditësi I. S., hynë në këtë banesë, në mënyrë të kundërligjshëm duke e pushtuar të njëjtën, ashtu që të paditurit nuk i është mundësuar shfrytëzimi i kësaj banese. Po ashtu ka theksuar se kishte iniciuar procedurën e lirimit të banesës kontestuese pranë HABITAT-it,

Kërkesa me numër DS 0010023 dhe Kërkesa me numër DS000871, ndërsa kjo e fundit me vendimin grupor nr. HPCC/D/110/2004/ A&C, të datës 13.02.2004, ka vendosur: kërkesa e kategorisë A Refuzohet (kategoria A i referohet paditësit), paraqitësi i kërkesës kategoria C (i referohet të paditurit), i jepet në posedim prona kontestuese në afate prej 30 ditëve, kundër këtij vendimi parashtruesi i kategorisë A, ka paraqitur ankesë, ndërsa me Vendimin numër HPCC/48/2005, të datës 18.06.2005, ku kërkesa nr.DS000871 dhe DS0001023 është refuzuar, duke shtuar se vendimet e formës se prerë të HPD-së, nuk mundë të shqyrtohen në asnjë gjykatë në Kosovë edhe padia e paditësit duhet të refuzohet si e pa pranueshme.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi, ka shtuar se qëndron pranë parashtrësë të datës 28.09.2023, po ashtu ka theksuar se paraardhësi i paditësve asnjëherë nuk e ka fituar këtë të drejtë banesore bile është dënuar për veprë penale, cenim i vulës të cilën e ka vendosur Habitati në derë me vendimin K.nr.1/08, të datës 13.05.2007, po ashtu ka shtuar se paditësit nuk kanë legjitimitet aktiv, duke kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzon si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për përfaqësim dhe për dy parashtrësia sipas Tarifës së OAK-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 02.11.2023, sipas propozimit të palëve ka administruar provat relevante dhe atë: Aktvendimin mbi ndarjen e banesës në shfrytëzim 04.nr.360-82/73, i datës 21.04.1988, Njoftimin me numër 360-7, i datës 08.08.1991, Parashtrësia për mos lidhje të Kontratës për shfrytëzim me numër 0502/1991, Vërtetimi nga NPB-ja, Aktvendimi me 04.nr.360-70-15/92, i datës 20.11.1992, Aktvendimi me numër 04.360-70-15/92, i datës 20.11.1992, Kontrata për qiranë e banesës me numër 1193/15703, Aktvendimi me numër 34.360-5353/98-2, i datës 28.12.1988, Kontrata e shitblerjes e banesës me numër 452-167/99, e datës 21.06.1999, Vendimi i vërtetuar nga Komisioni i kërkesave pronësore banesore i datës 13.02.2004, Vendimi i datës 13.12.2004, Vendimi i datës 13.12.2004, Vendimi i vërtetuar mbi kërkesën për shqyrtim, i datës 18.06.2005, Vendimi mbi kërkesën e shqyrtuar, të datës 18.06.2005, Vendimi mbi kërkesën e rishqyrtimit të datës 26.03.2007, Kontrata e shitjes e datës 30.01.2008, Deklarata e datës 04.02.2008, Transaksioni i konsumatorit nga KEK, i datës 16.04.2008, Ekstrakti nga librat e kontabilitetit nga KRU "Prishtina", e datës 11.04.2008, Aktgjykimi nga Gjykata Komunale në Prishtinë me numër. 1/07, i datës 25.05.2009, Aktvendimi mbi shqyrtimin e trashëgimisë me numër LRP-Tr.-nr.1418/12, i datës 02.11.2012, disa botime në gazetata ditore, Parashtrësia e datës 07.09.2006 nga Kuvendi i

Kosovës, Fatura nga KRU “Prishtina”, me nr.7043376, e datës 01.04.2013, Vendimi me numër 761/07, e datës 21.03.2008, Vendimi numër 309/2008, i datës 12.05.2008 dhe Aktvendimi i datës 15.09.2019.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se në këtë çështje juridike kontestimore kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestues fakti se paraardhësit juridik të paditësve, I. S. (tani i ndjeri), ju kishte ndarë në shfrytëzim Banesa në Prishtinë, në lagjen “D.”, Rr.9, B-1, L-4, K-8, banesa numër 32, në sipërfaqe prej 60.83 m², nga Sekretariati Krahinor i Punëve të Brendshme, me Aktvendimin mbi ndarjen e banesës në shfrytëzim, me numër 04. Nr.360-82/73, të datës 21.04.1988, si punëtor i SKPB.

Nga njoftimi me numër 360-7.7, i datës 08.08.1991, vërtetohet fakti se I. S., ka pranuar njoftimin, për anulimin e vendimit për ndarjen e banesës, nga Sekretariatit Krahinorë për Punë të Brendshme.

Nga parashtresa për mos lidhjen e kontratës për shfrytëzim me numër 03/1/392/1 i datës 05.02.1991, vërtetohet fakti se punëtorëve të Sekretariatit Krahinorë për Punë të Brendshme, në Prishtinë, me vendimin e Komisionit për Banim të Sekretariatit Krahinorë për Punë të Brendshme, kanë marrë banesa në shfrytëzim, mirëpo punësimi i tyre në këtë organ ka përfunduar, duke kërkuar që të mos lidhin kontrata për shfrytëzimin e banesës me punëtorët e shënuar në ankesë e këtij akti ku në numrin 11. është edhe emri i paraardhësit juridik të tani paditësve, në përputhje me nenin 14, paragrafi 4 të Ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e SRB, nr. 12/90), duke konsideruar se kushti për marrjen e banesës ka përfunduar, në përputhje me nenin 26, par 1, pika 6 të këtij ligji.

Nga Aktvendimi 04nr.360-70-15/92, i datës 20.11.1992, vërtetohet fakti se të paditurit M. B., si punëtorë i MPS, të Republikës së Serbisë - Sekretariatit, në Prishtinë, i jepet me qira në kohë të caktuar, banesa në Lagjen D.i K-VIII, nr., ndërsa nga Kontrata me numër 1193/15703, vërtetohet fakti se Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë ka lidhur Kontratë mbi qiranë me M. B., në bazë të vendimit të dhënësit MUP - Krahinor, po ashtu nga Aktvendimi 34 nr. 360-5353/98-2, i datës 28.12.1998, i është ndarë me qira me afat të pacaktuar, punëtorit të MUP-it, tani të paditurit M. B.. Nga Kontrata e shitblerjes së banesës me numër 452-167/99, e datës 21.06.1999, vërtetohet

fakti se Republika e Serbisë, përfaqësuar nga zëvendësministri i Financave I. M., ka lidhur kontratë me M. B., në cilësinë e blerësit për banesën në Lagjen D. K-VIII, nr., tani lëndë kontesti në këtë procedurë.

Nga gjendja faktike e vërtetuar si më lartë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve nuk ka bazë ligjore dhe të njëjtën e ka refuzuar, ngase me Aktvendimin mbi ndarjen e banesës në shfrytëzim, i datës 21.04.1988, provohet fakti se banesa objekt kontesti i është ndarë në shfrytëzim ish punëtorit të vet, I. S., nga Sekretariati Krahinor i Punëve të Brendshme, paraardhësit juridik të paditësve, i cili për ta fituar të drejtën banesore, sipas nenit 11 të Ligjit mbi marrëdhëniet banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83, 29/86 dhe 42/86) që në atë kohë ishte në fuqi, duhet që në mënyrë kumulative të plotësoheshin tri kushte: t'i jetë ndarë banesa me vendim të veçantë, të jetë lidhur kontrata për shfrytëzimin e banesës me organin kompetent dhe që të jetë vendosur në banesë, të cilat kushte duhet të plotësoheshin të gjitha së bashku, por në rastin konkret nuk janë plotësuar, sepse paraardhësi juridik i paditësve, nuk e ka lidhur kontratën për shfrytëzimin e banesës me organin kompetent, pasi që nga parashtresa për mos lidhjen e kontratës për shfrytëzim me numër 03/1/392/1, e datës 05.02.1991, punëtorëve të Sekretariatit Krahinorë për Punë të Brendshme, në Prishtinë, me vendimin e Komisionit për Banim të Sekretariatit Krahinorë për Punë të Brendshme, punëtorët të cilët kanë marrë banesa në shfrytëzim, mirëpo punësimi i tyre në këtë organ ka përfunduar, andaj është kërkuar që të mos lidhin kontrata për shfrytëzimin e banesës me punëtorët e shënuar në ankesë të kësaj parashtrese ku është cekur edhe emri i tani të ndierit I. S., ndërsa paditësit nuk kanë prezantuar kurrfarë prove se paraardhësi i tyre e kishte kundërshtuar në ndonjë formë ligjore këtë qoftë në procedurë të përcaktuar sipas Ligjit për Marrëdhënie Banesore, apo në procedurë gjyqësore, e të cilën banesë i padituri i'a kishte shitur personit të tretë S. M..

Me nenin 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, të vitit 1978, është përcaktuar se “Kontrata që është në kundërshtim me parimet e përcaktuara me kushtetutë të rregullimit shoqëror me dispozitat e detyrueshme apo me moralin e shoqërisë vetëqeverisëse socialiste është nul, në qoftë se qëllimi i rregullës së shkelur nuk sjell ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diçka tjetër”, ndërsa me nenin 111 po të këtij ligji thuhet se “Kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidhur pala me zotësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është caktuar në këtë ligj ose me dispozitë të veçantë“, andaj gjykata gjeti nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e pacaktuara ligjore për anulim të Kontratave si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret, paditësit me asnjë provë nuk kanë mundur të argumentojnë se banesa kontestuese ka qenë e paraardhësit juridik të tyre, I.S., andaj gjykata duke u bazuar në Ligjin mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (LMTHJP) Gazeta zyrtare e RSFJ nr.6/80), i cili ka përcaktuar kushtet dhe mënyrat për fitimin e pronësisë të sendeve të paluajtshme, në mënyrë që një transaksion lidhur me pronën, të konsiderohet si i ligjshëm, ku me nenin 20 të këtij ligji parashikon se “e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj”. Ndërsa neni 33 i po këtij ligji përcaktonte se “në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj”.

Ndërsa lidhur me kërkesën për lirim të banesës objekt kontesti në këtë procedurë gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 37 të LMTHJP, ku thuhet se “Pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale.

Pronari duhet të provojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet nën zotërimin faktik të të paditurit e drejta e paraqitjen së padisë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk parashkruhet”. Përgjatë kësaj procedurë gjyqësore, nuk u arrit të argumentohet se paditësit kanë të drejtën e pronësisë dhe meqenëse fillimisht duhet të provohet e drejta e pronësisë dhe më pas të kërkojë lirim të sendit, andaj gjykata gjeti se kjo kërkesë është e pabazuar për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të të paditurit për mungesë të legjitimitetit aktiv të paditësve, gjykata vlerësoi se në rastin konkret paditësit kanë legjitimitet aktiv, në këtë procedurë pasi që sipas Aktvendimit mbi trashëgimin LRP-Tr-Nr. 1418/12, vërtetohet fakti se paditësit janë shpallur trashëgimtar të të ndierit I. S., andaj për gjykatën ky pretendim ishte i pabazuar.

Sa i përket çështjes së diskriminimit në procedurën e humbjes së të drejtave banesore, legjisllacioni i aplikueshëm e pamundëson trajtimin e çështjeve që lidhen me diskriminimin e cila ka qenë kompetencë e Komisionit përkatës, sipas Rregullores 1999/23, të UNMIK-ut, neni 2 par. 2.7 parasheh se “Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovës”, andaj gjykata gjeti se në rastin konkret ka vendosur ky Komision, në lidhje me këtë kërkesë.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar të gjitha provat dhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në zgjidhjen e çështjes ndryshe përtej asaj që është vendosur

në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 2 dhe 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale, ngase paditësit nuk kanë pasur sukses në procedurë, ndërsa përfaqësuesi i të paditurit edhe pse i ka kërkuar mirëpo nuk i ka specifikuar se cilat shpenzime i kërkon.

Andaj duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. 256/2019, datë 20.11.2023

Gjyqtari
Egzon Mujaj

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.